



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 9340 prot.

Shkodër, më 22.4. 2026

**NJOFTIM
Për këshillim me publikun**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 18 dhe nenit 54, shkronja “k”, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe të Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Këshilli Bashkiak Shkodër njofton organizimin e një seance këshillimi me publikun, me qëllim diskutimin e dokumentit si më poshtë:

1. **Projektvendim:** “Për përcaktimin e çmimit maksimal të çadrave dhe shezlongëve për zonën bregdetare Velipojë–Rrjoll, për zbatim nga subjektet private”.

Takimi do të zhvillohet:

Ditën e enjte, më datë 21 maj 2026, ora 13:30, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Shkodër.

Sugjerimet dhe komentet mund të dorëzohen deri në përfundim të afatit të konsultimit, konkretisht deri më datë **21 maj 2026**, në formë të shkruar:

- pranë zyrës së protokollit të Bashkisë Shkodër;
- me postë;
- ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al

Ftojme qytetarët, grupet e interesit dhe çdo palë të prekur të marrin pjesë aktivisht në këtë proces konsultimi publik.

Duke ju falënderuar,

SEKRETARE

Sabina Dana

